



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2665, datë 11.02.2016

Për

*“Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Altelecom sh.a për Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2664, datë 14.01.2016”*

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. Sara Reçi, në mbledhjen e datës 11.02.2016, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

*Shqyrtimin e ankimit administrativ të sipërmarrësit Altelecom sh.a për Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2664, datë 14.01.2016*

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Ligji nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**ligji nr. 8485**), i ndryshuar;
3. Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
4. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP;

5. VKD nr.2664, datë 16.01.2016, për *“Monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe pezullimin e fillimit të efekteve të simetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare të përcaktuara me Vendim nr. 2542, datë 13.03.2015 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014”*”

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e Albtelecom sh.a me Nr. 1071, datë 4.02.2016, (referencë AKEP nr.prot 300, datë 5.02.2016);
2. Shkresa e Albtelecom, Telekom Albania sh.a. dhe Vodafone Albania sh.a. me Referencë Ref CEO/001/SK, datë 22.01.2016 (Referenca e AKEP: Nr.529 Prot., datë 22.01.2016), drejtuar AKEP dhe për dijeni institucioneve kryesore në Shqipëri.
3. Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (Relacioni);

si dhe duke i'u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

## **V Ë R E N :**

1. AKEP me VKD nr.2664, datë 16.01.2016, për *“Monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe pezullimin e fillimit të efekteve të simetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare të përcaktuara me Vendim nr. 2542, datë 13.03.2015 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014”*”, vendosi midis të tjerave: *Të pezullojë fillimin e zbatimit të efekteve të masave rregulluese të vendosura nga AKEP për vlerat e tarifave të terminimit për periudhën 1.01.2016 e në vazhdim të përcaktuar në tabelat në pikat 2/a dhe 4/a të Vendimit nr.2542, datë 13.03.2015, për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014”*”.
2. Albtelecom me shkresën me Nr. 1071, datë 4.02.2016, (referencë AKEP nr.prot 300, datë 5.02.2016) ka ankimuar në rrugë administrative VKD Nr.2664, datë 14.01.2016, për *“Monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe pezullimin e fillimit të efekteve të simetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare të përcaktuara me Vendim nr. 2542, datë 13.03.2015 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014”*”, duke kërkuar nga AKEP shfuqizimin/revokimin e tij
3. Albtelecom kërkon revokimin e këtij akti, i cili vjen në kundërshtim me Ligjin si në aspektin procedural ashtu edhe në atë material. Sipas Albtelecom, nga ana

proceduriale, VKD 2542 është marrë si rezultat i shqyrtimit të ankimit administrativ dhe është subjekt i shqyrtimit gjyqësor, ndaj dhe si i tillë nuk mund të rimerret në shqyrtim administrativ nga ana e AKEP, pasi cenohen rendë parimet e sigurisë juridike. Kjo, për shkak të pasigurisë që shkakton situata ku një vendim që po shqyrtohet në rrugë gjyqësorë rimerret në shqyrtim dhe ndryshohet nga organi administrativ, pasi ky i fundit është shprehur tashmë njëherë mbi këtë vendim. Edhe nëse VKD 2664 është konsideruar nga AKEP si monitorim i situatës në treg, AKEP gjendet përballë shkeljes së detyrimit ligjor për publikimin e rezultateve të monitorimit të këtij tregu, kryerjes së procesit të këshillimit publik me palët e interesit, marrjen dhe publikimin e komenteve të palëve. Duke mos kryer asnjë nga këto procedura deri në marrjen e Vendimit 2664, AKEP ka shkelur qartësisht procedurat në lidhje me procesin e vendimarrjes për tarifën nën rregullim të operatorit dhe rrjedhimisht ky Vendim është i pavlefshëm. Në aspektin material VKD 2664, duke pezulluar simetrinë e tarifave në favor të Plus, bie ndesh me Ligjin 9918, i ndryshuar, dhe praktikën më të mirë në BE. Plus ka kaluar fazën ku mund të justifikohet asimetria. Vec të tjerash Albtelecom sqaron se ndërhyrja në treg nga AKEP dhe aplikimi i masave patën sukses, por eliminimi i asimetrisë i bashkërenduar me rregullin e mosdiskriminimit, përben një masë të domosdoshme për të maksimizuar funksionimin eficient dhe dhenien e efekteve të duhura në treg nga aplikimi i rregullit të mosdiskriminimit.

4. Albtelecom sh.a në përfundim të pretendimeve të dhëna kërkon nga AKEP:
  - a. Revokimin e VKD-se së AKEP nr.2664, date 14.01.2016 Per "Monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe pezullimin e fillimit të efekteve të simetrise së tarifave të terminimit në rrjetet celulare të percaktuara me Vendim nr. 2542, date 13.03.2015 për "Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 date 06.11.2014" dhe heqjen e asimetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare midis operatorëve celulare, si akt absolutisht i pavlefshëm.
  - b. pezullimin e efekteve të këtij akti dhe pranimin e këtij ankimi
5. Albtelecom sh.a në një shkresë të përbashkët me sipërmarrësit Vodafone Albania sh.a. dhe Telekom Albania sh.a, me Referencë Ref CEO/001/SK, datë 22.01.2016 (Referenca e AKEP: Nr.529 Prot., datë 22.01.2016), drejtuar AKEP dhe për dijeni institucioneve kryesore në Shqipëri, pretendon se VKD nr.2664, datë 16.01.2016 është në kundërshtim me ligjin 9918/2008, rekomandimin e KE të vitit 2009, ligjin "Për ndihmen shtetërore" dhe ligjin "Për investimet e Huaja", duke krijuar ndihmë shtetërore diskriminuese në favor të operatorit Plus Communication. Në përfundim të pretendimeve të sipërmarrësit e cituar kërkojnë nga AKEP rishikimin e qendrimit të tij dhe marrjen e masave të menjehershme në lidhje me Vendimin nr. 2664 date 14.01.2016 si të pabazuar në ligj dhe absolutisht të pavlefshëm.
6. AKEP pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe argumentet e Albtelecom sh.a shprehet si më poshtë vijon:
  - a. AKEP me Vendimin nr.2664, date 14.01.2016 miratoi "Monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe pezullimin e

fillimit te efekteve te simetrise se tarifave te terminimit ne rrjetet celulare te percaktuara me Vendim nr. 2542, date 13.03.2015 per "Disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimet e Keshillit Drejtues te AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 date 06.11.2014".

- b. Vendimi nr. 2664, date 14.01.2016 i KD të AKEP është në linjë me pikën 14 të pjesës arsyetuese të Vendimit nr.2542, datë 13.03.2013, ku AKEP është shprehur: *“AKEP do të monitorojë nga afër zhvillimet në tregun celular, tarifat me pakicë si dhe efektet në trafikun on-net/off-net dhe pagesat neto midis operatorëve, dhe konkurrencën në tregun me pakicë celularë, për të gjykuar mbi nevojën e rishikimit të masave të mësipërme”*. Monitorimi i efekteve të tarifave të rregulluara është në përputhje dhe me nenin 52, pika 3 e ligjit 9918.
- c. Vendimi i Keshillit Drejtues te AKEP nr. 2664, date 14.01.2016, ka natyrë të përkohëshme pezulluese për një pikë të vecantë të Vendimit nr.2542, datë 13.03.2015, dhe objekti i këtij vendimi nuk është i njëjtë me çështjen gjyqësore të cituar nga Albtelecom<sup>1</sup>. Në çështjen gjyqësore të cituar, sipërmarrësi Plus Communication sh.a. kërkon midis të tjerave revokimin e Vendimit nr.2542, datë 13.03.2015, në lidhje me tarifat e terminimit në rrjetin Plus më 1.04.2015, 1.07.2015 dhe 1.01.2016 duke lënë në fuqi tarifën e terminimit të Plus në nivelin 6.52 lek/min deri në Analizën e radhës së tregut celular. Ndërsa Vendimi nr. 2664, date 14.01.2016, nuk ka rikthyer tarifën 6.52 lek/minutë të kërkuar nga Plus dhe nuk përbën shqyrtim ankimi administrativ për Vendimin nr.2542, datë 13.03.2015, por ka pezulluar aplikimin simetrisë dhe tarifës së terminimit në rrjetin Plus Communication prej 1.48 lek/minutë nga data 1.01.2016, për shkak të:
- i. nevojës së AKEP për monitorim të mëtejshëm të efekteve të zbatimit të detyrimeve të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net në tregun celular, përfshirë efektet e zbatimit të detyrimit nga data 1.01.2016 për përdoruesit me kontratë (kontrata me programe tarifore standarde dhe të personalizuar/specifike);
  - ii. cënimit të mundshëm të interesit publik për një konkurrencë të qëndrueshme aftagjatë në tregun celular.
  - iii. parashikimit të pikës 14 të pikës arsyetuese të Vendimit nr.2542, datë 13.03.2015.

Ankimi në shkallë gjyqësore, për sa kohë nuk është marrë vendimi i formës së prerë nga gjykata, si dhe për shkak të objekteve të ndryshme të kërkit, nuk e cënon të drejtën e AKEP si organ administrativ për të kryer veprime administrative.

---

<sup>1</sup> Çështja gjyqësore me Paditës Plus Communication Sh.a, palë e paditur AKEP, dhe objekt padie: Shfuqizimi i pjesshëm i VKD nr.2542, datë 13.03.2015 në lidhje me:

1. Shtesat e bëra në VKD nr.2522, datë 6.11.2014 në lidhje me vlerat e reja të tarifave të terminimit në rrjetin Plus për periudhat 1.04.2015, 1.07.2015 dhe 1.01.2016 duke lënë në fuqi tarifën e terminimit të Plus në nivelin 6.52 lek/min deri në Analizën e radhës së tregut celular.
2. Ndryshimin e bëra në VKD nr.2522, datë 6.11.2014 në lidhje me vlerat e reja të tarifave të terminimit në rrjetin Plus për periudhat 1.04.2015, 1.07.2015 dhe 1.01.2016 duke lënë në fuqi tarifën e terminimit të Plus në nivelin 6.52 lek/min deri në Analizën e radhës së tregut celular.
3. Ndryshimet e bëra në Vendimet 2522, 2523, 2525 dhe 2526, datë 6.11.2014 në lidhje me shtyrjen e afateve të detyrimit të mos-diskriminimit në tarifat on-net/off-net....dhe hyrjen me efekt nga data 01.01.2015 ....dhe zbatimin e këtij detyrimi për të tre operatorët e konsoliduar në treg Vodafone Albania, AMC dhe Albtelecom

- d. Keshilli Drejtues i AKEP ne asnje rast nuk ka shkelur standardet e trajtimit te drejte e te barabarte te operatoreve dhe ka zbatuar te gjitha Rekomandimet e Komisionit European dhe ne asnje rast nuk eshte lejuar diskriminimi i operatorëve mbi baza kombësie, perkundrazi fakti që sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike që janë në pronësi të investitorëve të huaj zoterojnë rreth 95 % te tregut te komunikimeve elektronike nuk justifikon ankimin e Albtelecom per diskriminimin e investitorëve të huaj.
- e. Vendimi nr. 2664, date 14.01.2016 i sherben qëllimit të ligjit 9918 dhe objektivave rregullatore për garantimin e konkurrencës së lirë në treg, duke respektuar parimet e objektivitetit, transparences, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe per interesin publik. Vendimi është marrë ne pershtatje me kushtet specifike te tregut celular për të garantuar qëndrueshmërinë e stimujve per investime eficente ne rrjetet celulare, te cilat, në terma afatgjate sigurojne me shume konkurrence dhe i shërbejnë mbrojtjes së interesit publik.
- f. Në lidhje me pretendimet për datën 14.01.2016 të marrjes së vendimit 2664, dhe pezullimit të aplikimit të tarifës së terminimit 1.48 lek/minutë në rrjetin Plus duke filluar nga data 1.01.2016, dhe përdorimit të tarifës 2.66 lek/minutë, AKEP sqaron se rakordimet dhe faturimet për terminimin e trafikut në rrjetet e operatorëve kryhen pas përfundimit të muajit përkatës (muaji Shkurt për rastin konkret), sipas përcaktimeve të ofertave referencë/marrveshjeve të interkoneksionit dhe legjislacionit tatimor.
- g. Vendimi nr. 2664, date 14.01.2016, ka natyrë të përkohëshme pezulluese, dhe argumentat e Albtelecom sh.a, në lidhje me tarifën e terminimit në rrjetin Plus Communication sh.a duke filluar nga 1.01.2016, do të trajtohen në Vendimin e AKEP, i cili sipas pikave 1 dhe 4 të VKD nr. 2664, datë 14.01.2016, do të marrë në konsideratë dhe rezultatet e monitorimit të efekteve të mos-diskriminimit në tarifatat on-net/off-net në tregun celular dhe do të merret nga AKEP brenda 90 ditëve nga data 14.01.2016.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

*Bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 146, të Kodit të Procedurave Administrative,*

## **V E N D O S:**

1. Lënien në fuqi të Vendimit të Keshillit Drejtues të AKEP me nr. 2664, datë 14.01.2016, për “*Monitorimin e efekteve të mos-diskriminimit të tarifave on-net/off-net dhe pezullimin e fillimit të efekteve të simetrisë së tarifave të terminimit në rrjetet celulare të përcaktuara me Vendim nr. 2542, datë 13.03.2015 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526 datë 06.11.2014”*”, dhe rrezimin e ankimit të sipërmarrësit Albtelecom sh.a të depozituar me shkresën me Nr. 1071, datë 4.02.2016, (referencë AKEP nr.prot 300, datë 5.02.2016);
2. Të njoftohet sipërmarrësi Albtelecom sh.a. për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [www.akep.al](http://www.akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

- 1. Alban KARAPICI**
- 2. Anila DENAJ**
- 3. Ketrin TOPÇIU**
- 4. Klarina ALLUSHI**